

KËSHILLI I BASHKISË KORCË

VENDIM
Nr.8, Datë 21.03.2007

MBI NJË SHITESË NË LISTËN E PRIORITETEVE TË INVESTIMEVE TË BASHKISË PËR VITIN 2007

Këshilli i Bashkisë së Qytetit të Korcës, në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria Arsimore “Mbi përcaktimin e prioriteteve të investimeve për vitin 2007”, mbështetur në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” Neni 32, gërma “dh”, Neni 10 dhe Neni 72, në Ligjin Nr. 8399, datë 09.09.1998, “Për buxhetin Lokal” në kompetencat që ka si dhe pas diskutimeve të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë prioritetet e investimeve për vitin 2007, të cilat do të financohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës si më poshtë:
 1. Shtesë në Shkollën 9-vjecare “Mësonjëtorja e Parë Shqipe”, me fondin prej 41 000 000 lekë
 2. Ndërtim catie dhe rrethim i Shkollës “Stavri Themeli”, me fondin prej 14 000 000 lekë.
 3. Ndërtim i një shkolle të re 9- vjecare me fondin prej 82 000 000 lekë.
 4. Ndërtimi një shkolle të re të mesme të përgjithshme, me fondin prej 82 000 000 lekë.
 5. Shtesë në Shkollën 9-vjecare “Sotir Gura”, me fondin prej 39 000 000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Punëve Publike, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Urbanistikës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Raimonda NASE

Raimonda Nase